



KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Administratës
Periudha raportuese	Korrik, 2020
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Vasilika Zotaj

1. PËRMBLEDHJE

Sektorët me përpikëri kanë realizuar detyrat e parashtruara dhe të kërkuara nga ato. Është vërejtur fluks i madhe i qytetarëve në sektorët e Zyrës së Gjendjes Civile. Për shkak të pandemisë Coronavirus - Covid 19, kemi pasur shumë ngarkesë, për arsye se stafi është reduktuar në Institucionet e Republikës së Kosovës.

AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

Drejtoria e Administratës është duke realizuar edhe një numër të projekteve tjera, të cilat nuk janë paraparë sipas Planit të veprimit në fillim të vitit, por të cilat projekte dalin si nevojë në përkrahje të avancimit të shërbimeve ndaj qytetarëve. Të gjitha këto projekte do të listohen në raportet e muajve të ardhshëm.

2. STATISTIKAT SEKTORIALE

	Drejtoria	Pranuar	Në proces	Miratuar	Refuzuar	Pezulluar	Anuluar	Përfunduar	Totali
1	Drejtoria e Administratës	6	149	399	0	0	0	7,974	8,524
2	Drejtoria e Shëndetësisë	0	56	0	0	0	0	0	56
3	Drejtoria e Arsimit	0	124	0	7	19	1	0	134
4	Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm	0	53	173	1	0	0	0	227
5	Drejtoria e Urbanizimit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit	2	194	12	0	0	1	0	209
6	Investimet Kapitale dhe Menaxhimi i Kontratave	0	96	1	0	0	0	0	97
7	Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit	5	274	4	0	0	1	0	283
8	Drejtoria e Kulturës	0	8	1	0	0	0	0	9
9	Drejtoria e Inspeksioni	0	299	46	0	0	2	0	347
10	Drejtoria e Financave	23	507	8,140	0	0	5	0	8,675
11	Drejtoria e Kadastrit	3	580	1,425	0	0	19	0	2,027
12	Drejtoria e Bujqësisë	0	16	4	0	0	0	0	20
13	Kabineti i Kryetarit	12	4,132	356	0	0	7	0	4,507
14	Drejtoria e Pronës	0	15	3	0	0	0	0	18
15	Drejtoria e Mirëqenies Sociale	0	35	1	0	2	0	0	38
16	Drejtoria e Sportit	0	17	0	0	0	0	0	17
17	Drejtoria e Parqeve	0	7	0	0	0	0	0	7
		52	6,562	10,565	8	4	34	7,974	25,199

3. GJENDJA CIVILE

Udhëheqës i Gjendjes Civile - Fehmi Kupina

1	Ekstrakte të lindjes	9,244
2	Certifikata të lindjes	5,938
3	Certifikata të martesës	1,192
4	Certifikata të vdekjes	751
5	Certifikata të vendbanimit	219
6	Certifikata të shtetësisë	105
7	Certifikata të bashkësisë familjare	1,133
8	Vërtetim nga Arkivi	
9	Status martesor	466
	Gjithsej	

4. SEKTORI I TI-SË

Udhëheqës i Sektorit për TI - Hysen Hyseni

Gjatë muajit korrik, 2020, Sektori për teknologji informative, ka ofruar këto shërbime:

- Kemi krye shërbime softuerike dhe harduerike, për administratën komunale dhe institucioneve tjera komunale:
 - instalimi dhe konfigurimi i sistemeve operative, programeve aplikative,
 - instalimi dhe konfigurimi i serverëve,
 - instalimi dhe konfigurimi i kompjuterëve për operim funksional në rrjetë,
 - instalimi dhe konfigurimi i printerëve, fotokopjeve, ploterëve digjital, senderëve etj.,
 - identifikimi dhe zgjidhja e problemit të sistemit operativ dhe programeve aplikative,
 - identifikimi dhe zgjidhja e problemeve harduerike,
 - identifikimi dhe zgjidhja e problemeve në rrjetin lokal (LAN);
- Jemi kujdesur për siguri në teknologji informative, në rrjeta, aparate, sisteme dhe programe të cilat punojnë dhe ruajnë të dhëna të ndjeshme. Kemi bërë kopjet (backup) ruajtjen e të dhënave të rëndësishme nga bazat e të dhënave të ndryshme që kemi në komunë;

- Kemi mirëmbajtur serverët e Komunës së Prishtinës;
- Kemi bërë mirëmbajtjen e infrastrukturës së rrjetit LAN dhe, sipas nevojës, kemi bërë kyçjen e kablove në kabinete, switch-a, dhe përcaktimi i porteve;
- Kemi vazhduar krijimin e llogarive në e-mail zyrtar për stafin e Komunës, në bashkëpunim me MAP/Agjencinë për Shoqëri të Informacionit (ASHI);
- Kemi mirëmbajtur E-kiosqet e Komunës së Prishtinës;
- Kemi mirëmbajtur sistemin e menaxhimit të radhës;
- Kemi bërë monitorimin e mbledhjeve të KK të Prishtinës përmes teleprezencës;
- Kemi azhurnuar informatat në aplikacionin E-shpenzimet;
- Përditësimi i informatave në ueb-faqen zyrtare dhe “Prishtina Online”;

Kemi menaxhuar dhe mbikëqyrur këto projekte:

- Platforma për hapjen e të dhënave “Prishtina Open Data”;
- Kemi menaxhuar dhe mirëmbajtur Platformën digjitale për participim publik;
- Aplikacionin mobil për Prishtinën;
- Aplikacionin “Ndreqe.com”;
- Menaxhim i Data-bazës së klientëve për projektin e shërbimeve publike “Menaxhimi i Mbeturinave”.

Kemi menaxhuar dhe mbikëqyrur këto kontrata:

- Kontratën e AQP-së “Shfrytëzimi i fotokopjeve dhe printerëve me qira”;
- Furnizimi me pajisje të TI-së, për nevojat e Komunës;
- Furnizimi me toner për nevojat e Komunës së Prishtinës;
- Mirëmbajtja e sistemit të menaxhimit elektronik të automjeteve me pajisje GPS;
- Vendosja e E-kiosqeve nëpër BL-të e Komunës, montimi, konfigurimi i tyre.

Gjatë muajit korrik 2020, është bërë furnizimi (ndërrimi) me kompjuterë të ri për Qendrën për shërbim me qytetarë, sportelet e Tatimit në pronë, dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike.

5. SEKTORI I LOGJISTIKËS

Udhëheqës i Sektorit – Rifat Gashi

Sektori teknik ka zhvilluar aktivitetin e tij në mbështetje të Planit vjetor të punës, në mbështetje të Rregullores mbi organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës.

Gjatë kësaj periudhe është bërë:

- Sigurimi i objekteve të Komunës;
- Mirëmbajtja e ndërtesave të Komunës;
- Mirëmbajtja e higjienës në objektet e Komunës;
- Shërbimet hoteliere nga bufeja e Komunës për zyrtarët e Komunës;
- Mirëmbajtja e ashensorëve në objektin e ri dhe të vjetër të Komunës;
- Organizimi dhe menaxhimi i shfrytëzimit të automjeteve zyrtare;
- Byroteknika ka bërë fotokopje të materialeve - 30947 copë.

6. SEKTORI I BASHKËSIVE LOKALE

Shefi i Sektorit të BL-ve - Fadil Leci

Gjatë periudhës korrik 2020, në Sektorin e BL-ve janë kryer këto punë:

Është punuar në vlerësimin e tenderit për ndërtimin e objektit të Bashkësisë Lokale në Marec;
Është bërë menaxhimi i kontratë për pastrimin e objekteve të Komunale;

Është intervenuar në rregullimin e ujit në objektin e Bashkësisë Lokale te Xhamia e Llapit;

Kemi pritur dhe udhëzuar qytetarët për realizimin e të drejtave të tyre që janë në kompetencë të sektorit të BL-ve.

Takimet me institucione të tjera

- Vizitë BL-ve dhe zyrave të Ofiqarisë në qytet dhe fshatra - mbledhja e informacioneve dhe njohja nga afër me problemet që mund të shoqërojnë funksionimin normal të bashkësive lokale dhe ofiqarive.

Lëndët e pranuara, të kryera dhe në përfundim e sipër

- Të gjitha lëndët e pranuara janë shqyrtuar, por një pjesë e tyre është në proces (kërkesat për punë praktike – mblidhen dhe pastaj intervistohen të gjithë ata që kanë parashtruar kërkesë; kërkesat për kompensime nga dëmet e shkaktuara të natyrave të ndryshme). Të gjitha tjerat janë të përfunduara, siç edhe shihet në tabelën e raportimit të sektorit të Qendrës së shërbimit për qytetarë.

Takime të tjera

- Takime të rregullta me shefat e sektorëve në kuadër të Drejtorisë së Administratës.

SFIDAT

- Kemi pasur sfida në pajisjen e punëtorëve, si dhe qytetareve, me pajisje mbrojtëse, si doreza, maska dhe dezinfektues në mbrojtje nga pandemia Coronavirus-Covid 19;
- Sfidë ka qenë edhe mbajtja e rendit për shkak të fluksit të madh të qytetarëve dhe reduktimi i stafit për shkak të pandemisë.

REKOMANDIME

- Të kontrollohet në mënyrë të vazhdueshme mbarëvajtja e punonjësve të Komunës;
- Të kontrollohen punonjësit për përdorimin e mjeteve mbrojtëse, si doreza, maska, dezinfektues dhe distanca;
- Të kontrollohen për mbajtjen e pajisjeve mbrojtëse, si doreza, maska dhe dezinfektues, nëse jo, të iu sigurohen.

AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES

Pajisja në vazhdimësi e objekteve të bashkësive lokale me kompjuterë dhe printerë, atje ku mungojnë. Në momentin e lirimit të fluksit të punës së Hortikulturës, kemi marrë aprovimin se do të na mbështesin për gjelbërimin e territorit përpara bashkësive lokale.

7. RAPORTI I KOMISIONIT PËR ANKESA

Në bazë të Vendimit për hapjen e kutive të ankesave, komisioni hapi kutitë e ankesave më 04. 08. 2020, sipas planprogramit, dhe i shqyrtoi, duke i ndarë nëpër objekte, të cilat paraqiten sipas tabelës.

Nr.	Drejtoria	Numri i ankesave
1.	Objekti i ri i Komunës	6
2.	Objekti i vjetër i Komunës	0
GJITHSEJ		6

Komisioni: Nefi Krasniqi, Fehmi Kupina, Fadil Leci

8. KUVENDI I KOMUNËS

Punët dhe detyrat e shefit të Sektorit.

1. Luljeta Selimi, u.d. e udhëheqëses së Sektorit të Kuvendit

Punët dhe detyrat e udhëheqësit të Sektorit të Kuvendit, kryesisht ndërlihen me organizimin dhe koordinimin e punëve brenda sektorit, si për ndarjen e punëve dhe në kujdesin për angazhimin e plotë të punëtorëve, që këto punë të kryhen në mënyrë më të rregullt.

Gjatë muajit korrik 2020, është punuar kryesisht rreth organizimit dhe përgatitjes së materialeve për mbledhjen e katërt të Komitetit për Politikë dhe Financa. Gjithashtu është punuar rreth organizimit dhe përgatitjes së materialeve për mbledhjen e katërt të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Njëherësh janë punuar edhe punë të tjera që ndërlidhen me natyrën e këtij sektori.

Raporti i punëve të kryera nga punonjësit e Shërbimit të Kuvendit:

2. Zijadin Gashi, zyrtar i lartë për punë profesionale të Kuvendit komunal, ka kryer këto punë:

Ka përgatitur ekstraktin e procesverbalit të mbledhjes së tretë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.
Ka marrë pjesë në përgatitjen e materialit për mbledhjen e katërt të Komitetit për Politikë dhe Financa.
Ka marrë pjesë në përgatitjen e materialit për mbledhjen e katërt të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.
Ka kryer edhe punë të tjera sipas kërkesës të u.d. shefit të Sektorit të Kuvendit.

3. Shyhrete Islami, zyrtare e lartë për punë profesionale të Kuvendit komunal, nuk ka raport të punës.

4. Shefki Jashari, zyrtar për lekturim, ka kryer këto punë:

Ekstrakti i mbledhjes së dytë të Komitetit të PAK	6 f.	6.7.2020
Ekstrakti i mbledhjes së tretë të KPF-së	5 f.	10.7.2020
Raporti i Drejtorisë së Administratës, maj 2020	20 f.	10.7.2020
Ekstrakti i mbledhjes së parë të KKV-së	3 f.	10.7.2020
Raporti i DIKMK-së, qershor 2020	55 f.	14.7.2020

Raporti i Drejtorisë së Shëndetësisë, qershor 2020	9 f.	14.7.2020
Raporti i Drejtorisë së Inspeksionit, qershor 2020	8	14.7.2020
Raporti i Drejtorisë së Urbanizmit, qershor 2020	11 f.	20.7.2020
Raporti financiar i Komunës së Prishtinës për TM- 2	30 f.	21.7.2020
Raporti i Drejtorisë së Administratës, qershor 2020	21 f.	23.7.2020
Raporti i Drejtorisë së Arsimit, janar 2020	15 f.	27.7.2020
Raporti i Drejtorisë së Arsimit, mars 2020	14 f.	27.7.2020
Raporti i Drejtorisë së Arsimit, qershor 2020	13 f.	28.7.2020
Raporti i Drejtorisë së Kadastrit, qershor 2020	7 f.	28.7.2020

5. Miranda Pacolli Dibra, zyrtare për përkthim, shqip- serbisht, ka kryer këto punë:

Përrurimi i këndit të lodrave			01.07.2020
Masat e reja mbrojtëse			01.07.2020
Ekipet e Inspeksionit në terren			15.07.2020
Vazhdimi i punimeve në rregullimin e hapësirës së parkingut			15.07.2020
Vendosja e shiritave drithërues			15.07.2020
Kryetari Shpend Ahmeti, priti në takim ministrin e Ekonomisë			15.07.2020
Asfaltimi i rrugës “Iliaz Kodra”			16.07.2020
Parkingu te rruga “Adrea Gropa”			16.07.2020
Vazhdimi i sinjalizimit			16.07.2020
Po testohen 60 personat e parë			17.07.2020
Vazhdimi i punimeve			18.07.2020
Infrastruktura e parkingjeve në lagjen “Dardania” po përmirësohet			21.07.2020
Kryetari Shpend Ahmeti, mirëpret në takim z. Lulëzim Basha			21.07.2020
Parkingjet private në Prishtinë			22.07.2020
Uka Gashi	3		22.07.2020

Rasim Kavaja	2		23.07.2020
Parkingjet private duhet të pajisen me leje			23.07.2020
Parkingu në lagjen “Dardania” po merr pamje të re			24.07.2020
Monumenti “New Born” do të vendoset mbi një bazë			24.07.2020
Fehim Shala			24.07.2020
Vizita e Kryetarit në zhvillimet e punimeve në lagjen “Dardania”			25.07.2020
Vazhdimi i dezinfektimit të rrugëve			26.07.2020
Parku i Taukbahçes			27.07.2020
Drejtori i Inspeksionit pret në takim drejtorin e Odës Ekonomike			29.07.2020
Inspektorët e rendit			29.07.2020
Vazhdojmë zbatimin e vendimeve			30.07.2020

6. Lendita Spahija, zyrtare për mbështetje administrative teknike të Kuvendit komunal, nuk ka raport të punës.

7. Albina Behluli, zyrtare për përkthim, shqip- serbisht, gjendet në pushim mjekësor.

8. Arton Brahim, zyrtar për arkiv 1, ka kryer këto punë:

Ka ndihmuar në përgatitjen e materialit, duke përgatitur propozimvendime dhe materiale të ndryshme për mbledhje të KPF-së.

Në bashkëpunim me udhëheqësen e Sektorit, ka kryer edhe punë tjera të cilat i përkasin sektorit të Kuvendit.